



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGIJSLATURA VIII

Sesioni pranveror

Komisioni për Integrim Evropian
Mbledhja nr. 90

Prishtinë, dt. 04.07.2024, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 303

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Rrezarta Krasniqi, Fjolla Ujkani, Shqipe Isufi, Driton Hyseni, Blerta Deliu-Kodra dhe Time Kadrijaj.

Munguan: Fridon Lala, Agon Batusha, Alban Bajrami dhe Elmi Reçica.

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Adelina Demolli, Ahtere Loxha dhe Safet Beqiri.

Mbledhjen e kryesoi Rrezarta Krasniqi, kryetare e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë, e hapi mbledhjen.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 13.6.2024 dhe 19.6.2024;
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-290 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.08/L-013 për të drejtat pronësore të shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës, nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-288 për mbrojtjen e konsumatorit, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
5. Të ndryshme.

1.Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua.

Miratimi i procesverbaleve nga mbledhja e datës 13.06.2024 dhe 19.06.2024

Procesverbalet u miratuan pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-290 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.08/L-013 për të drejtat pronësore të shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës, nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryetarja, lidhur me këtë, tha se projektligji ka për qëllim që personat e huaj fizikë dhe juridikë të komunitetit shqiptar nga Komuna e Preveshës, Medvegjës dhe Bujanovcit në Republikën e Serbisë, kanë të drejtë të jenë titullar i të drejtave pronësore në territorin e Republikës së Kosovës, sipas kushteve të përcaktuara me ligjin bazik, duke e përjashtuar parimin e reciprocitetit.

Ky projektligj përmban gjithsej 3 nene dhe asnjë amendament të paraqitur nga Komisioni funksional dhe nuk është paraparë në PKIE 2024-2028.

Legjislacioni primar dhe sekondar i BE-së nuk përmban akte juridike të cilat në mënyrë specifike mbulojnë fushën e këtij projektligji, dhe si e tillë, kjo fushë mbetet në kompetencë të brendshme të shteteve anëtare të BE-së. Pra, ky projektligj nuk transponon legjislacion të BE-së, përkatësisht nuk është pjesë e procesit të harmonizimit dhe përafrimit me Acquis të BE-së dhe mund të rekomandohet për miratim në Kuvend.

Hapi diskutimin dhe e hodhi projektligjin në votim.

Pas votimit, kryetarja konstatoi se Komisioni, me shumicë votash, nxori këtë:

Përfundim

Projektligji nr. 08/L-290 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 08/L-013 për të drejtat pronësore të shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe rekomandohet për miratim në Kuvend.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-288 për mbrojtjen e konsumatorit, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryetarja, lidhur me këtë projektligj, tha se ka për qëllim rregullimin e kushteve të tregut në marrëdhëniet biznes-konsumator, duke përfshirë etiketimin e produkteve, treguesit e çmimeve, shërbimet publike dhe praktikën e padrejta tregtare, si dhe të drejtave të konsumatorëve në lidhje me kontratat, duke përfshirë kushtet e padrejta të kontratës, shitjeve në distancë dhe jashtë objekteve afariste, mospërputhshmëria me kontratat.

Ky projektligj përmban gjithsej 145 nene dhe 26 amendamente nga Komisioni funksional dhe

nuk është në kundërshtim me legjislacionin e përgjithshëm të BE-së, përkatësisht është pjesërisht në përputhje me Acquis të BE-së, andaj ky projektligj mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt në Kuvend.

Hapi debatin.

Driton Hyseni, tha se ka qenë kryetar i grupit punues gjatë amendamentimit të këtij projektligji dhe është konstatuar në Komision se është në përputhje me legjislacionin e BE-së dhe inkurajoi Komisionin ta votojnë.

Kryetarja e hodhi në votim Projektligjin së bashku me amendamentet, dhe pas votimit, konstatoi se Komisioni, me shumicë votash, nxori këtë:

Përfundim

Projektligji 08/L-288 për mbrojtjen e konsumatorit, me amendamentet e Komisionit funksional nuk është në kundërshtim me legjislacionin e përgjithshëm të BE-së, është pjesërisht në përputhje me Acquis të BE-së, andaj rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt në Kuvend.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetare e Komisionit

Rrezarta Krasniqi